



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**BASHKIA HIMARË**  
**KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 414 prot.

Himarë, më 23.01.2024

**PR O J E K T V E N D I M**

Nr. 5, datë 23.01.2024

**“PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 33, DATË 28.07.2023, TË KËSHILLIT TË BASHKISË HIMARË, “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK HIMARË””**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, nenit 54, shkronja “a” të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, lligjit nr.8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, ligjit nr.44, datë 30.04.2015 “ Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”,

**V E N D O S A:**

1. Në tekstin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e Këshillit Bashkiak Himarë, të miratuar me VKB-në nr.33, datë 28.07.2023, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

**Neni 1**

Neni 32 ndryshohet, si më poshtë vijon:

**Neni 32**

**Emërtimi i Komisioneve të Përhershëm**

Këshilli i Bashkisë ka **7 (shtatë)** Komisione të Përhershme të emëruara si më poshtë:

1. Komisioni i mandateve, 3 anëtare/ë
2. Komisioni i ekonomisë, finance dhe auditit, 5 anëtare/ë
3. Komisioni i bujqësisë, pyjeve, kullotave dhe aseteve të bashkisë, 5 anëtare/ë
4. Komisioni i shërbimeve mbështetëse ( arsimi, kultura, rinia, sporti dhe turizmi), 5 anëtare/ë
5. Komisioni i zhvillimit urban, infrastrukturës dhe shërbimeve publike, 7 anëtare/ë
6. Komisioni i barazisë gjinore dhe i përfshirjes sociale, 5 anëtare/ë
7. **Komisioni i integritit evropian, 5 anëtare/ë.**

2. Komisioni i integritit evropian të përbëhet nga pesë (5) këshilltarë, tre nga shumica dhe dy nga pakica, dhe të ngrihet me vendim të Këshillit Bashkiak kur votojnë “Pro” shumica e Këshilltarëve. Në përcaktimin e përbërjes së Komisionit respektohen kërkesat e barazisë gjinore. Propozimet për anëtarët e Komisionit bëhen nga kryetarët e Grupeve të Këshilltarëve të cilët ia paraqesin Kryetarit të Këshillit.

Komisionit i integritit evropian do të jetë përgjegjës dhe ka të drejtë :

- Të mbështesë dhe koordinojë strukturat e bashkisë, në realizimin e reformave për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga procesi i anëtarimit në BE.
- Të monitoroj programimin dhe zbatimin me efikasitet të gjithë financimeve në kuadër të programeve të BE-së dhe donatorëve të tjerë, nga të cilat përfiton bashkia.
- Komisioni merr në shqyrtim raportin e vlerësimit të performancës së bashkive në procesin e integritit evropian i cili hartohet dhe raportohet çdo vit kalendarik.
- Këshilltarët janë pjesë e aktiviteteve që Kryetari i Bashkisë, me mbështetjen e strukturës së Integritit Evropian, organizon në Bashki, në bashkepunim me strukturat e qeverisë qendrore, Delegacionin e BE në Tiranë, si dhe përfaqësitë e vendeve anëtare të BE-së.
- Këshilltarët njihen me ecurinë e projekteve të financuara nga fondet e BE-se, të cilat janë pjesë e projekteve të bashkisë dhe donatorëve të tjerë, nëpërmjet raporteve të përgatitura 2 herë në vit nga administrata e bashkisë.
- Këshilltarët mund të kërkojnë një seancë konsultimi më të gjithë aktorët lokalë dhe Kryetarin e Bashkisë për të diskutuar rezultat mbi performancën e bashkisë bazuar në vlerësimin vjetor të performancës së bashkive në procesin e integritit evropian, si dhe masat që duhet të ndërmerren për ato aspekte të vlerësimit ku Bashkia duhet të përformoj më mirë.

**Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar.**

**KRYETARI I KËSHILLIT**

**Dhimitër Kapaj**







REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**BASHKIA HIMARË**  
**KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 414/1 prot.

Himarë, më 23.01.2024

**RELACION**

**MBI PROJEKTVENDIMIN “PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 33, DATË 28.07.2023, TË KËSHILLIT TË BASHKISË HIMARË, “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK HIMARË””.**

**Të nderuar,**

Në vijim të zbatimit të angazhimeve që pushteti vendor ka në kuadër të zbatimit të rekomandimeve për anëtarësimin në Bashkimin Evropian, në strukturën e Këshillit Bashkiak gjykohet e nevojshme që të krijohet komisioni i përhershëm i integritit evropian. Misioni i këtij komisioni do të jetë:

- Të mbështesë dhe koordinojë strukturat e bashkisë, në realizimin e reformave për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga procesi i anëtarësimin në BE.
- Të monitoroj programimin dhe zbatimin me efikasitet të gjithë financimeve në kuadër të programeve të BE-së dhe donatorëve të tjerë, nga të cilat përfiton bashkia.
- Komisioni merr në shqyrtim raportin e vlerësimit të performancës së bashkive në procesin e integritit evropian i cili hartohet dhe raportohet çdo vit kalendarik.
- Këshilltarët janë pjesë e aktiviteteve që Kryetari i Bashkisë, me mbështetjen e strukturës së Integritit Evropian, organizon në Bashki, në bashkepunim me strukturat e qeverisë qendrore, Delegacionin e BE në Tiranë, si dhe përfaqësitë e vendeve anëtare të BE-se.
- Këshilltarët njihen me ecurinë e projekteve të financuara nga fondet e BE-se, të cilat janë pjesë e projekteve të bashkisë dhe donatorëve të tjerë, nëpërmjet raporteve të përgatitura 2 herë në vit nga administrata e bashkisë.
- Këshilltarët mund të kërkojnë një seancë konsultimi me të gjithë aktorët lokalë dhe Kryetarin e Bashkisë për të diskutuar rezultat mbi performancën e bashkisë bazuar në vlerësimin vjetor të performancës së bashkive në procesin e integritit evropian, si dhe masat që duhet të ndërmerren për ato aspekte të vlerësimit ku Bashkia duhet të përformoj më mirë.

**Për këtë arsye,** Neni 32 i rregullores për organizimin dhe funksionimin e Këshillit Bashkiak Himarë, të miratuar me VKB-në nr.33, datë 28.07.2023, ndryshohet, si më poshtë vijon:

## Neni 32

### Emërtimi i Komisioneve të Përhershëm

Këshilli i Bashkisë ka **7 (shtatë)** Komisione të Përhershme të emëruara si më poshtë:

1. Komisioni i mandateve, 3 anëtare/ë
2. Komisioni i ekonomisë, finance dhe auditit, 5 anëtare/ë
3. Komisioni i bujqësisë, pyjeve, kullotave dhe aseteve të bashkisë, 5 anëtare/ë
4. Komisioni i shërbimeve mbështetëse ( arsimi, kultura, rinia, sporti dhe turizmi), 5 anëtare/ë
5. Komisioni i zhvillimit urban, infrastrukturës dhe shërbimeve publike, 7 anëtare/ë
6. Komisioni i barazisë gjinore dhe i përfshirjes sociale, 5 anëtare/ë
- 7. Komisioni i integritit evropian, 5 anëtare/ë.**

SEKRETARI I KËSHILLIT

Elena Memushaj

